



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.431/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Nehat Idrizi kryesues, Nenad Lazić dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV), dega në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Prishtinë, për shkak të vendosjes së banerit mbi rrugën publike, për Zgjedhjet Lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 04.11.2013, mori këtë:

VENDIM

Miratohet si e bazuar ankesa e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV), dega në Prishtinë, kështu që subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Prishtinë i shqiptohet dënimi më gjorbë në vlerë prej 1800 (njëmijë e tetqind) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e pranimit të këtij vendimi.

Arsyetim

Me datën 02.11.2013, PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga LVV, në të cilën theksohet se me datën 02.11.2013, rrethë orës 14:00 në afërsi të Pallatit të Rinisë në Prishtinë më saktë në udhëkryq aktivistet e LVV, kanë vrejtur se anëtarë të subjektit politik PDK, kanë vendosur banerin e kandidatit të tyre për kryetar Komune mbi rrugë publike, dhe po ashtu është vendosur në këtë datë duke e ditur se është heshtje zgjedhore. ku me këtë veprim sipas parashtruesit të ankesës janë shkelur dispozitat ligjore mbi Zgjedhjet Lokale, neni 33 pika b) si dhe dispozitat e nenit 3.4 të Rregullores Zgjedhore 11/2013 të KQ –së. Ndërsa shkelja tjetër e këtij subjekti është vendosja e materialit zgjedhore në periudhën e heshtjes zgjedhore siq është paraparë në nenin 7 pika b e Rregullores Zgjedhore 13/2013, neni 8 pika f Rr. Z. 13/2013 dhe neni 36 pika b të LZP-së.

Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur dy fotografi si dëshmi.

PZAP-i, në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, e informoi subjektin politik PDK, me datën 03.11.2013, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 03.11.2013, brenda afatit të caktuar PZAP-i, pranoi përgjigjen në ankesë në të cilën theksohet se më të pranuar njoftimin për dukjen e banerit të kandidatit të PDK-së mbi rrugën publike, menjëher është intervenuar dhe hequr baneri i kandidatit për kryetar Komune të Prishtinës, ka bërë largimin e

këtij baneri, dhe ka ofruar fotografi në të cilën dëshmohet veprimi i largimit të banerit të vendosur mbi rrugët publike të Prishtinës, sipas të dhënave që kemi nga tereni përsonat e panjohur kanë bërë një veprim të tillë.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

Ankesa është e bazuar

Nga fotografit të cilat gjenden në shkresat e lendes identifikohet qartë se baneri i kandidatit të PDK-së për kryetar të Komunës të Prishtinës është i vendosur mbi rrugë publike siç pretendohet në ankesën e të cilin veprim subjekti politik PDK ka rënë në kundërshtim me dispozitat ligjore të nenit 33 pika b) të LZP-së.

Për përcaktimin e lartësisë së gjobës të vendosur në dispozitiv të këtij vendimi PZAP-i, ka marrë parasysh faktorët në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

PZAP-i, mori parasysh të gjitha rrethanat si rënduese ashtu edhe rrethanat lehtësuese. Si rrethanë rënduese mori se ka marr pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara dhe se konsiderohet se është e njoftuar me procesin zgjedhor dhe faktin se banerin e kandidatit për kryetar komune në Prishtinë kanë qenë të vendosur në vendin e palejuar për vendosjen e banerit. Ndërsa si rrethanë lehtësuese PZAP-i, mori se PDK, pas marrjes së kërkesës për përgjigjes në ankesë nga PZAP-i, brenda afatit të caktuar, ka ndërmarr veprime të dukshme për evitimin e shkeljes, duke i larguar menjëherë fotografit nga vendi ku pretendohet se ka ndodhur shkelja e supozuar.

Andaj PZAP-i duke marr parasysh të gjitha arsyet e lartcekura se nga ana e PDK-së është shkelur neni 4 paragrafi 1 pika "b" të Rregullës Zgjedhore 11/2013 të KQZ-së dhe nenin 33 pika b) të LZP-së, pasi që banerin e kandidatit për kryetar të komunës të PDK-së janë vendosur mbi rrugët publike, si dhe duke pasur parasysh veprimet e menjëhershme të subjektit politik PDK-së, për evitimin e shkeljes së supozuar si dhe përpjekjet për të parandaluar veprimet e ndaluara në bazë të provave të cilat i ka ofruar të bashkangjitura përgjigjes në ankesë të cilat veprime kanë ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptua, në kuptim të nenit 3.2 të Rregullës 01/2012 të PZAP-it, nenit 120 paragrafi 1 pika c), si dhe nenit 118.1 të LZP-së, PZAP-i vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashitja
Anr. 431/2013 më datën 04.11.2013.

Kryesuesi i Panelit
Nehat Idrizi



Këshillë Juridike: PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoha e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*